



**Z. Dritan Jano**

**PËRGJEGJËS I SEKTORIT  
TË PARAPAKETIMEVE**

## **Profili**

Diplomuar në fushën e Ekonomisë dhe Agrobiznesit në Universitetin Bujqësor të Tiranës në vitin 2009, z. Dritan Jano ka ndërtuar një karrierë të konsoliduar në administratën publike, kryesisht në fushën e metrologjisë dhe sigurimit të cilësisë.

Karrierën profesionale e ka nisur në vitin 2012 si metrolog (specialist i autorizuar) pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, duke vijuar më pas si inspektor dhe më tej si specialist në sektorin e parapaketimeve për disa vite. Gjatë kësaj periudhe ka kontribuar në kontrollin dhe mbikëqyrjen e produkteve të parapaketuara, duke zbatuar standardet kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e metrologjisë.

Që prej vitit 2021, ushtron detyrën e Përgjegjës të Sektorit të Parapaketimeve, ku drejton dhe koordinon aktivitetet për sigurimin e përputhshmërisë së produkteve me kërkesat ligjore dhe standardet përkatëse.

Gjatë karrierës së tij ka ndjekur një sërë trajnimesh profesionale brenda dhe jashtë vendit, përfshirë trajnime të organizuara nga institucione ndërkombëtare si OIML, PTB dhe programe të Bashkimit Evropian. Në vitin 2025 është certifikuar për sistemet e kontrollit të përmbajtjes së parapaketimeve (e-mark), duke forcuar më tej eksperjencën e tij në këtë fushë.

**[dritan.jano@dpm.gov.al](mailto:dritan.jano@dpm.gov.al)**